

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit në Prishtinë, - në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit B.K. nga Gjakova, rr. "...” për shkak të veprës penale kanosje në vazhdimësi nga neni 185 par 2 lidhur me nenin 81 par.1.1 dhe pika 1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas ankesës së të dëmtuarës F.B., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P.nr.251/2018 të datës 24.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 22.02.2019, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së të dëmtuarës F.B., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P.nr.251/2018 i datës 24.12.2018, ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit B.K., për veprën penale kanosje në vazhdimësi nga neni 185 par 2 lidhur me nenin 81 par.1.1 dhe pika 1.5 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar, Gjykata e Apelit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve .

II.Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P.nr.251/2018 të datës 24.12.2018, i akuzuari B.K., është shpallur fajtor për veprën penale kanosje në vazhdimësi nga neni 185 par 2 lidhur me nenin 81 par.1.1 dhe pika 1.5 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër të re penale. Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 19.09.2018 deri më 18.10.2018. I akuzuari është obliguar që në emër të paushalit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 30€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E nga Istogu, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka parashtruar e dëmtuara, F.B., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqiptojë një dënim me burg efektiv konform veprës dhe sjelljes së tij ashti siç e parasheh ligji.

Prokurori i Apelit i Kosovës, me shkresën PPA/II.nr.83/2019, me datë 15.02.2019, ka propozuar që ankesa e të dëmtuarës të aprovohet pjesërisht si e bazuar vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin ashtu që të akuzuarit B.K., për veprën e kryer

penale ti shqiptohet dënim më i ashpër ndërsa sa i përket shkeljes së ligjit penal, ankesa të hudhet si e palejueshme.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se

- Ankesa e të dëmtuarës F.B. është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e kanë pranuar fajësinë dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve të paraqitura në ankesë.

Kolegji penal i kësaj Gjykate, pas leximit të ankesës, vlerësoi se e njëjta është parashtruar vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin edhe pse është potencuar në ankesë se e njëjta parashtrohet edhe për shkelje të ligjit penal, prandaj edhe është vlerësuar dhe shqyrtuar vetëm përkitazi me pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë ankimore.

E dëmtuara në ankesë thekson se vendimi mbi dënimin i shqiptuar ndaj të akuzuarit B. është tepër i butë dhe se ky dënim, nëse mund të quhet ashtu, do ta stimulojë të njëjtin edhe më tepër për të kryer vepra penale në vazhdimësi. Sipas ankesës, i akuzuari meriton të dënohet më rëndë sepse i njëjti është i njohur për rrethin dhe organet e rendit si njeri arrogant, shkelës i ligjit dhe i dënuar edhe më herët. Se veprën penale e ka kryer me vetëdije të plotë dhe se të dëmtuarën vazhdon ta kërcënojë edhe më tutje, dëshmohet me akuzat e tjera, për të cilat është dënuar edhe më herët dhe se edhe tani vazhdon me të njëjtin avaz, për çka e dëmtuara mund ta pësojë ehe më rëndë dhe se i akuzuari B. ka qenë i dënuar për të njëjtat veprime me aktgjykimin P.nr. 276/18 dhe çuditërisht gjykata e shkallës së parë i shqipton dënim me kusht përkundër rrethanave të lart cekura. Sipas ankesës, edhe pse për veprën e kryer nga i akuzuari, me ligj është paraparë dënimi me burg deri një vit, gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënim me kusht dhe nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat rënduese të rastit, se i akuzuari është person arrogant, i pasjellshëm, i dënuar edhe më parë për vepër të njëjtë, i rrezikshëm dhe person që nuk ndien keqardhje apo pendim për veprat e kryera dhe se tek i njëjti nuk mund të gjindet asnjë rrethanë lehtësuese. E dëmtuara me ankesë i ka propozuar kësaj gjykate që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me burg efektiv duke marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrën me të cilën është kryer vepra penale dhe rrezikut që i kanoset.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, Gjykata e Apelit në prezencën e rrethanave rënduese dhe të mos vlerësimit të tyre nga ana e gjykatës së shkallës së parë, vlerëson se pretendimet ankimore të dëmtuarës janë të bazuara, sepse rrethanat lehtësuese në rastin konkret janë mbivlerësuar ndërsa rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar drejt, se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vlerësuar intenzitetin e rrezikimit që në

momentin e kryerjes së veprës penale i është kanosur tani të dëmtuarës, pastaj motivin e kryerjes së veprës penale, si dhe kohën, mënyrën dhe pasojat e mundshme të veprës së kryer penale, që kohëve të fundit është në rritje e sipër në vendin tonë dhe paraqet rrezikshmëri të zmadhuar shoqërore, rrethanë të cilën gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar dhe pasojat të cilat rrjedhin nga kryerja e kësaj vepre penale

Kolegji penal i kësaj gjykate duke shqyrtuar ankesën e të dëmtuarës, gjen se pretendimet e saj për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv ndaj të akuzuarit, janë të bazuara, për faktin se kjo gjykatë konsideron se rrethanat e konstatuara dhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë nuk justifikojnë shqiptimin e dënimit si të mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit, ngase dënimi i shqiptuar nuk është në proporcion me intensitetin e të mirës së mbrojtur, e as me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor e aq më tepër kur është fakt i njohur se i akuzuari B. edhe më parë ka qenë i dënuar me dënim me gjobë për vepër penale ndaj të njëjtës së dëmtuar, që dëshmon se dënimi i shqiptuar nuk e ka arritur qëllimin e dënimit, se i njëjti ka vazhduar me kanosjet ndaj tani të dëmtuarës, prandaj kolegji penal i Gjykatës së Apelit ankesën e të dëmtuarës e aprovoi si të bazuar, mori parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë dhe në prani të rrethanave të lart cekura, të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të pandehurit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.61/2019, me 22.02.2019

Zyrtari ligjor

Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,

1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit

2. Shqipe Qerimi

3. Afrim Shala